

Syllabusi i lëndës

Lënda: Da've

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 4

Statusi i lëndës: Zgjedhore

Kodi i lëndës: 112

Fondi i orëve: 2+0

Viti akademik: 2026-2027

Semestri: i -II-rë

Mësimdhënësi: Prof. Ass. Dr. Rexhep Suma

Përmbajtja e shkurtër e lëndës

Lënda e Da'ves në fokus do të ketë rolin dhe mision e thirrësit në fenë islame, metodologjinë dhe mesataren në zbatimin dhe shtrirjen e ligjëratave të tij. Etika dhe morali i lartë që duhet të zotëroj thirrësi. Nevoja dhe domosdoshmëria që duhet të radhiten prioritetet në misionin e tij dhe të prolongohen gjërat sekondare.

Qëllimi i lëndës

Qëllimi i kursit nga lënda "Da've" tu ofroj studentëve dije të avancuar teorike dhe eksperiencë në këtë fushë duke ofruar njohuri teorike lidhur me da'ven, veçantitë e saj, strukturën, llojet dhe mjetet për në thirrjen islame. Puna në orët e lëndës (3 orë në javë) do të orientohet në përfitimin e dijes së sistemuar nga studentët, të cilët do të jenë pjesë aktive e procesit studimor, veçmas përmes punës në grupe. Puna në grupe do të ketë për qëllim të nxisë studentët për të krijuar qasje dhe qëndrime personale-kritike duke shprehur kështu edhe talentin e tyre intelektual përmes eseve, punimit të diplomave dhe punimit seminarik. Pra, ky kurs do t'iu ndihmojë studentëve që të ngrenë nivelin e përgjegjësisë që ka misioni i thirrjes islame në jetën e besimtarit si dhe të teksteve shkencore dhe të shprehen me një nivel të kënaqshëm akademik në shkrimet e tyre, si seminare, punime diplome etj. Studentët do të përvetësojnë gjithashtu edhe metodat e analizimit dhe leximit të burimeve primare dhe sekondare në mënyrë që t'i përdorin ato sa më mirë gjatë dhe pas studimeve bachelor. Studentët do të mësojnë gjithashtu kriteret që përdoren për strukturimin e punimit dhe përdorimit me efikasitet të materialeve të grumbulluara prej tyre gjatë punës kërkimore në sferën e da'ves. Sikurse ky modul synon

të aftësojë studentët që vetë të hulumtojnë dhe vlerësojnë dukuritë dhe fenomenet shoqërore që ka mjedisi ynë shqipfolës..

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të kursit studentit pritet të dijë, kuptoj ose të jetë në gjendje të demonstroj:

Njohuri:

- Të njohin nocionet dhe karakteristikat themelore të lëndës së da'ves në komunikime me masën.
- Të arrijnë të konceptojnë format dhe metodologjinë në komunikime në përputhje me veçantitë e tij strukturore.
- Të zotërojnë teknikën e përdorimit të drejtë të referencave.
- Të shkruajnë ese, punime seminarike dhe të diplomës bazuar në njohuritë e fituara teorike;
- Të jetë në gjendje të analizoj dhe debatojë efektet shumëdimensionale të burimeve të ndryshme të informacionit në mënyrë korrekte.
- Të menaxhoj në mënyrë praktikë më procesin e organizimit të një hulumtimi.

Shkathtësit/ Aftësit

- Të aftësohen për të bërë leximin kritik të teksteve universitare,
- Të aftësohen për të vlerësuar një tekst akademik,
- Të zhvillojnë në nivel të kënaqshëm aftësitë shprehëse, teknikat e thirrjes islame dhe hulumtimi në komunikime,
- Të jenë në gjendje të komunikojnë në mënyrë efektive duke shprehur idetë sa më efektivisht, duke dëgjuar me kujdes. Do të zhvillohen aftësi në komunikim verbal dhe joverbal, përgatitje dhe prezantim i materialeve mësimore, planeve, dokumenteve të vlerësimit, raporteve.
- Të arrij të dëshmoj dhe respektoj diversitetin në grupet me të cilat punojnë.
- Ndjenja e përgjegjësisë dhe marrjes së vendime të bazuara mbi drejtësi dhe barazi.

Kompetenca:

- Të dëshmoj aftësi në thellimin e njohurive shkencore dhe profesionale, si një lëmë i

domosdoshëm dhe i patjetërsueshëm, për krijim, pavarësim dhe aftësim në kryerjen e punëve të predikimit e daves.

-Studenti duhet të kryejë punime me nivel të lartë shkencor (ese, detyra kursi, punime të tjera, punime diplome etj.)

- Janë në gjendje të përdorin teknologjinë kompjuterike me qëllim të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave për t'i përdorur në procesin e planifikimit dhe përcaktimit të ngarkesave në ligjërata.

- Aftësia e komunikimit të mirë dhe organizimit të punës ekipore duke marrë përgjegjësi për suksesin e vet dhe të grupit.

- Përdorin, në mënyrë strategjike, njohurit nga fusha e pedagogjisë dhe didaktikes dhe janë në gjendje të respektojnë aspektet etike dhe sociale në kuadër të procesit të mësim nxënies.

Metodologjia e mësimdhënies:

Realizimi i mësimdhënies do të zhvillohet nëpërmjet ligjëratave dhe ushtrimeve nga lëmi i “Da’ves”. Në këtë kontekst, si forma të punës në interpretimin e përmbajtjeve të veprave do të jenë ligjëratat e rregullta, esetë, ushtrimet, diskutimet, puna në grupe dhe, për të gjitha këto, do të përdoren teknika dhe metodat e reja.

Natyra e lëndës mundëson shumëllojshmëri qasjesh të mësimdhënies dhe strategjive të mësimdhënies. Nga ju kërkohet reflektim kritik dhe qasje refleksive për të zhvilluar të menduarit kritik. Çdo formë e paraqitjes është e hapur për diskutim dhe modifikim përmes dakordimit të përbashkët.

- **Ligjërata** - Ligjëratat mbahen sipas orarit të publikuar në web faqe, www.fsi-edu.net. Inkurajoheni të jeni sa më aktiv dhe fleksibil si dhe të përfshirë në të gjitha detyrat që realizohen në klasë.
- **Ushtrimet praktike** – Pjesa e praktikës do të jetë demonstrim i njohurive dhe shkathtësive të përfituara në ligjërata si dhe me hulumtimin që përcaktohet nga profesori dhe studenti paraprakisht në funksion të temës.
- **Punë individuale dhe detyra** - Gjatë realizimit të mësimin do të keni edhe detyra individuale për të përmbushur obligimet. Detyrat mund të përzgjedhë nga:
 - Plani i orës i përgatitur për të mbajtur orën praktike.
 - Analizë e planit të ndonjërit nga shokët e grupit tuaj.
 - Vlerësim i ndonjë pjese të strukturës së orës me analizë të thellë dhe sqarim për çështjet specifike.
 - Projekt hulumtimi i propozuar për nxënësit i propozuar sipas formatit të lëndëve për mësim zgjedhorë.
- **Punim seminarik** – Punimi i seminarit duhet të jetë i karakterit hulumtues dhe duhet të përmbajë elementet përbërëse të një hulumtimi. Kjo mund të realizohet në formë si hulumtim rasti, analizë e literaturës specifike, projekt.

Përmbajtja e lëndës:

Nr.	Java	Ligjërata
1.	I	Prezantim i përgjithshëm i përmbajtjen e syllabusit dhe çështjeve që ndërlidhën me përmbajtjes së lëndës. Nocioni da've nga aspekti etimologjik dhe terminologjik në frymën e zhvillimeve bashkëkohore
2.	II	Pesha dhe rëndësia e urtësisë në thirrjen islame
3.	III	Metodologjia tradicionale dhe moderne
4.	IV	Urtësia peygamberike dhe zhvillimi i marrëdhënieve dhe shtrirja e komunikimit <u>të tij</u> me të jomuslimanët
5.	V	Thirrja islame përballë ndryshimeve bashkëkohore dhe nevoja për urtësinë dhe mesataren në fikhun e prioriteteve në da've
6.	VI	Thirrja islame dhe përshkallëzimi në e predikimit të fesë
7.	VII	Kollekfiumi I
8.	VIII	Metodologjia e thirrjes islame
9.	IX	Pesha e fjalës në thirrjen islame
10.	X	Norma të përgjithshme mbi ftuesin (ligjëruesin)
11.	XI	Morali dhe etika e thirrësit
12.	XII	Kategoritë e të thirrurve në fenë e Allahut
13.	XIII	Munafikët-Hipokritët dhe Përkufizimi i Gjynahqarëve
14.	XIV	Mëshira
15.	XV	Kollekfiumi II

Provimi përfundimtar

Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjëratë 10%

Punimi seminarik i prezantuar 20%

Testi intermedier 30%

Provimi final 40%

Total 100%

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studenti duhet të respektojë institucionin dhe rregullat e parapara:

- të respektojë orarin e ligjëratave;
- të mbajë disiplinën gjatë ligjëratave;
- t'i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi;
- të mos mbajë të kyçur celular, apo aparate tjera gjatë orëve të mësimit.

Literatura obliguese:

1. Ligjëratat përgatitura nga Prof.ass. Dr.Rexhep Suma
2. Rexhep Suma, Bazat e thirrjes islame, BIK, Prishtinë, 2025.
3. Jusuf Kardavi, Islami për të cilin ftojmë, Furkan, Shkup, 2022.
4. Jusuf Kardavi, Mesazhi ynë në epokën e globalizmit, Furkan, Shkup, 2018.
5. Abdulkerim Zejdani, Bazat e thirrjes, botues: Fondacioni i rinisë islame, Zurich
6. Rexhep Suma, Islami dhe Identiteti, Logos-A, Shkup, 2020.
7. Hisham Et-Talib, Udhëzues përgatitor për punonjësit islamikë, Logos-A, 1998.
8. Said Kahtani, Urtësia në thirrjen për në fenë e Allahut të madhëruar, Guraba, Gostivar, 2011.

Literatura shtesë dhe bibliografia:

9. Jusuf Kardavi, Edukimi kulturor i thirrësit, Prishtinë, 2002.
10. Fet'hi Jeken, Si të thërrasim në Islam, Furkan, Shkup, 2000.
11. Muhamed Kutb, Ne jemi thirrës e jo gjykatës, Liban, 1996
12. Rexhep Suma, Reflektim mendimesh në da've, FSI, Prishtinë, 2018.
13. Ahmed Galush, Da've islamije, 1971.
14. Tefik el Va'ji, Ed-vavetu ilell'llah, Egjipt, botim i II-të 1995.

Literatura e preferuar:

15. Mustafa Tahan, Gruaja në karvanin e thirrjes, Furkan, Shkup,2020.
16. Hisham Talib, Besëlidhja e thirrjes islame, Logos-A, Shkup,2017.
17. Ramazan Kayan, Thirrja islame akt profetik, Fleta, Prizren,2017.
18. Ramazan Tamer Büyükküpcü, Ta jetosh jetën sipas islamit, Alsar, Tiranë pa vit botimi.
Ahmed Tutunxhi, Mësime nga jeta ime, Logos-A, Shkup,2020

Kontributi në ngarkesën e studentit

Aktiviteti	Orë	Ditë\Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/ punë në laborator/ ushtrime	-	-	-
Punë praktike	1	15	15
Përgatitje për test intermediar	-	-	-
Konultime me mësime të mësimdhënësin	0.5	6	3
Puna në terren	2	1	2
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë ose në shtëpi)			3
Përgatitja përfundimtare për provim.			4
Koha e vlerësimit (teste, ese, provim final)			3
Totali			75